

## PËR LETËRNJOFTIMIN

("Gazeta Zyrtare", nr. 62/2006 dhe 36/2011)

### I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Nocioni i letërnjoftimit dhe qëllimi i tij

##### Neni 1

Letërnjoftimi është dokument publik me të cilin qytetarët e Republikës së Serbisë dëshmojnë identitetin e tyre.

Në përputhje me ligjin, letërnjoftimi shërben edhe si dëshmi për faktet tjera të përfshira në të.

Nëse është e caktuar me marrëveshje ndërkombëtare, letërnjoftimi mund të shërbejë edhe si dokument udhëtimi.

#### Të drejtën për letërnjoftim

##### Neni 2

Të drejtë për letërnjoftim ka çdo shtetas i Republikës së Serbisë (në tekstin e mëtejme: shtetasi), më i vjetër se 16 vjet.

Të drejtë për letërnjoftim ka edhe shtetasi më i vjetër se dhjetë vjet (në tekstin e mëtejme: fëmijë)

#### Detyrimi për të pasur letërnjoftim

##### Neni 3

Shtetasi mbi 16 vjeç me vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë është i detyruar të ketë letërnjoftim.

#### Të huajt dhe letërnjoftimi

##### Neni 4

Shtetasvetë huaj dhe personave pa shtetësi me vendbanim në territorin e Republikës letërnjoftimi iu jepet në kuadër të ligjit të posaçëm.

## **II VLEFSHMËRIA E LETËRNJOFTIMIT**

### **Neni 5**

Letërnjoftimi lëshohet me vlefshmëri prej 10 viteve, kurse fëmijëve me vlefshmëri prej pesë viteve.

Shtetasit mbi moshën 65 vjeç, me kërkesën e tij, mund ti lëshohet letërnjoftimi pa afatë kufizuar të vlefshmërisë, në formularin i cili nuk përmban një mikrolexues (çip).

Shtetasit i cili ka të drejtë për letërnjoftim, kurse nuk ka të paraqitur vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë, do t'i lëshohet letërnjoftimi në bazë të vendqëndrimit të caktuar me periudhë të vlefshmërisë prej dy viteve.

## **III KOMPETENCA E DHËNIES SË LETËRNJOFTIMIT**

### **Neni 6**

Letërnjoftimine lëshon në mënyrë të përcaktuar ministria përkatëse për punë të brendshme (në tekstin e mëtejme: organi kompetent).

Rregullorennga paragrafi 1 të këtij neni, e sjellë ministri përgjegjës për punë të brendshme (në tekstin e mëtejme: ministri).

## **IV FORMULARII LETËRNJOFTIMIT**

### **Përmbajtja e formularit**

### **Neni 7**

Letërnjoftimi lëshohet në formularin të cilin e përcakton ministri.

Në formularin e letërnjoftimitjepen të dhënat e paraprake rrethposeduesit të këtij dokumenti:

- 1) mbiemri;
- 2) emri;
- 3) gjinia;
- 4) dita, muaji dhe viti i lindjes;
- 5) vendi, komuna dhe shteti i lindjes;
- 6) numripersonal.

Në formularin e letërnjoftimit regjistrohen edhefotografisë e të dhënave biometrike të poseduesit të këtij dokumentit (fotografia, gjurma e gishtit dhe nënshkrimi).

Në formularin e letërnjoftimit regjistrohet edhe data e lëshimit të letërnjoftimit me afatin e vlefshmërisë së tij.

## **Leximi automatik i të dhënave. Elementet mbrojtëse**

### **Neni 8**

Formulari i letërnjoftimit përmban hapësirën për mikrolexuesin (çipin) dhe hapësirën për zonën e lexueshme për aparat për arsye të leximit automatik të të dhënave.

Nëse formulari përmban mikrolexuesin (çipin), në të regjistrohen të gjitha të dhënat e dukshme në letërnjoftim, si dhe të dhënat mbi shtetësinë, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin dhe adresën e banimit të poseduesit të tij dhe emrii njërit prind, ndërsa mund të regjistrohet edhe numri personal i prindërit të mbajtësit të letërnjoftimit.

Me kërkesë të poseduesit të letërnjoftimit, në përputhje me rregulloret e veçanta, në çip regjistrohen çertifikata e kualifikuar elektronike të poseduesit dhe të dhënat e duhura për formimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar, ashtu që ailetërnjoftim të bëhet mjet për formimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar, në përputhje me ligjin.

Letërnjoftimi përmban edhe elementet mbrojtëse të cilat i përcakton ministri.

## **Shtypja e formularit. Regjistrimi i të dhënave**

### **Neni 9**

Formulari i letërnjoftimit shtypet në gjuhën serbe, me shkrim qirilik, edhe në gjuhën angleze.

Formulari i letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin.

Në formularin e letërnjoftimit, të dhënat mbi mbiemrin dhe emrin regjistrohen në formën origjinale ashtu siç janë regjistruar nëçertifikatën e lindjes. Të dhënat mbi mbiemrin dhe emrin e pjesëtarit të pakicës kombëtare shënohen paralelisht edhe sipas drejtshkrimit dhe alfabetit serb.

Të dhënat tjera regjistrohen në gjuhën serbe, nëshkriminqirilik, në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin.

### **Neni 9a**

Të dhënat rreth mbiemrit dhe emrit të familjes së bartësit të kërkesës për letërnjoftim, në formularin e letërnjoftimit, me kërkesë të tij, përveç shkrimit qirilik mund të regjistrohen edhe në shkrimin latin, në qoftë se për këtëekziston mundësia teknike.

Mundësitë teknike, gjegjësisht kufizimetqë kanë të bëjnë me numrin e shenjave, sipas paragrafit 1 të këtij neni, regjistrohen të dhënat e duhura të cilat përcaktohen në bazë të nenit 6, paragrafi 2 të këtij ligji

## **V PROCEDURA PËR LËSHIMIN E LETËRNJOFTIMIT**

### **Kërkesa. Paraqitja e kërkesës**

#### **Neni10**

Letërnjoftimi lëshohet në bazë të kërkesës personale.

Kërkesa për lëshimin e letërnjoftimit i dorëzohet organit kompetent përmes njësive organizative në komuna, qytete dhe në qytetin e Beogradit, dhe gjithashtu mund të dorëzohet përmes misionit diplomatik ose konsullor të Republikës së Serbisë i cili duhet menjëherë t'ia dërgojëorganit kompetent.

Kërkesa për lëshimin e letërnjoftimitdorëzohetpersonalisht.

Për të miturit, apo personate paaftë për punë, kërkesën e dorëzon njëri nga prindërit me pëlqim me shkrim të prindit tjetër apo përfaqësuesit ligjor apo kujdestarit.

Personave të mitur më të vjetër se 16 vjet, letërnjoftimi i lëshohet pa pëlqimin e prindit tjetër, nëse qoftë se prindi nuk ushtron të drejtën prindërore.

Fëmijës i lëshohet letërnjoftimi, edhe pa pëlqimin e prindit tjetër, nëse prindi nuk ushtron të drejtën prindërore, sëbashku me vërtetimin eorganit kompetent të kujdestarisë se lëshimi i letërnjoftimit është në interes të fëmijës.

Për të përcaktuar identitetin dhe faktet tjera relevante për zgjidhjen e kërkesës për lëshimin e letërnjoftimit dhe të dhënave biometrike (fotografia, gjurma e gishtit, nënshkrimi),merastin e lëshimit të letërnjoftimitështëe nevojshme prania e personit të cilit i lëshohet letërnjoftimi.

Personi i referuar në paragrafin 7 të këtij neni, i cili në bazë të përkatësisë etnike, fesë ose zakoneve kombëtare mbanë kapelë ose shami si pjesë integrale e veshjes, mund të fotografohet me kapelë ose shami, në përputhje me rregulloren mbi mënyrën e marrjes së të dhënave biometrike.

Të dhënat biometrike të përmendura në paragrafin 7 të këtij neni, merren në mënyrën të cilën e përcakton ministri.

## **Afati për dorëzimin e kërkesës**

### **Neni 11**

Personat që sipas dispozitave të këtij ligji janë të obliguar të kenë letërnjoftim, kërkesën për letërnjoftim e bëjnë më së largu në afat prej 15 ditëve pasi të kenë mbushur 16 vjeç, ose brenda 15 ditëve pas plotësimit të kushteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji.

### **Neni 12**

Në kërkesën për letërnjoftim dorëzuesi i kërkesës duhet të deklarojë të dhëna të sakta.

## **Përmbajtja e kërkesës**

### **Neni 13**

Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që në kërkesën për letërnjoftim të japë të dhënat në vijim:

- 1) numrin personal;
- 2) mbiemrin dhe emrin;
- 3) gjininë;
- 4) datën e lindjes;
- 5) vendi, komuna dhe shteti i lindjes;
- 6) shtetësinë;
- 7) numrat personal për prindërit;
- 8) vendbanimi në territorin e Republikës së Serbisë (vendi, komuna dhe adresa e banimit) në momentin e parashtrimit të kërkesës;
- 9) shteti i huaj në të cilën jeton, për personat pa vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë;
- 10) datën e parashtrimit të kërkesës.

## **Dokumentet që ibashkangjiten kërkesës**

### **Neni 14**

Personi zyrtar, me rastin e pranimit së kërkesës dhe vërtetimit të identitetit të parashtruesit, urdhëron parashtruesin që ti vë në dispozicion dokumentin publikpërkatës të lëshuar në përputhje me të evidencat e përcaktuara zyrtare, në qoftë se organi kompetent nuk mundet sipas detyrës zyrtare të ketë qasje në të dhënat në sistemin qendror për përpunimin elektronik dhe ruajtjen e të dhënave, gjegjësisht gjatë kontrollit të të dhënave mbi shtetësinë, librin amëz të të lindurve, librit amëz të kurorëzimit, librit amëz të të vdekurve dhe evidencat tjera të cilat ai apo ndonjë ministri tjetër, në përputhje me ligjin, i kryejnë për të vërtetuar faktet rreth përmbushjes së kushteve për lëshimin e letërnjoftimit.

Personit të cilit për herë të parë i lëshohet letërnjoftimi, me kërkesën për letërnjoftim mund të bashkëngjies fotografinë e madhësisë së përcaktuar e cila me saktësi tregon dukjen e tij.

### **Vërtetimi mbi kërkesën e dorëzuar**

### **Neni 15**

Me rastin e dorëzimit të kërkesës për lëshimin e letërnjoftimit, aplikuesit i jepet vërtetimi në formularin të cilin e përcakton ministri, i cili shërben si dëshmi e kërkesës së dorëzuar.

### **Përcaktimi i numrit personal në rast kur ky numër nuk është përcaktuar**

### **Neni 16**

Në qoftë se në procesin e lëshimit të letërnjoftimitzbulohet që shtetasit i cili nuk ka lindur në territorin e Republikës së Serbisë dhe se në atë territor nuk ka vendbanim të përhershëm nuk iu është përcaktuar numri personal, organi kompetent është i obliguar, në përputhje me ligjin, t'i përcaktoj këtë numër shtetasit me rastin e lëshimit të letërnjoftimit.

Për të përcaktuar numrin personal në rastin e paragrafit 1 të këtij neni, për numrin e regjistrit (grupi IV) përcaktohet numri 70.

### **Afati për lëshimin letërnjoftimit.**

### **Neni 17**

Organi kompetent është i obliguar të lëshojë letërnjoftimin brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës.

Në rastet emergjente (trajtim mjekësor, sëmundje apo me rastin e vdekjes së një anëtari të familjes, udhëtim urgjentpune) ose për arsye të tjera justifikuara, në qoftë se për ato janë

përbushur kushtet të cilat i përcakton ministri, organi kompetent është i obliguar që të lëshojë letërnjoftim edhe në afatmë të shkurtër kohor.

## **Asgjësimi i letërnjoftimit të lëshuar më parë**

### **Neni 18**

Me rastin e dorëzimit të letërnjoftimit, organi kompetent është i detyruar që letërnjoftimin e lëshuar më parë ta asgjësojë.

Asgjësimi i letërnjoftimit kryhet në mënyrën të cilën e përcakton ministri.

## **VI OBLIGIMET E VEÇANTA NË LIDHJE ME LETËRNJOFTIMIN E LËSHUAR**

### **Ndalimi i përdorimit të letërnjoftimit. Lëshimi i letërnjoftimit të ri**

#### **Neni 19**

Poseduesi nuk mund të përdor letërnjoftimin:

- 1) në qoftë se të dhënat e tij personale kanë ndryshuar sipas nenit 7, paragrafit 2 të këtij ligji;
- 2) në qoftë se fotografia në letërnjoftim nuk korrespondon me pamjen e tij;
- 3) nëse letërnjoftimi është dëmtuar ose për ndonjë arsye tjetër nuk i shërben qëllimit;
- 4) në qoftë se më vonë e vëren se letërnjoftimi i tij përmban të dhënë të pasaktë.

Poseduesi i letërnjoftimit është i obliguar që të dorëzojë kërkesën për letërnjoftim të ri brenda 15 ditëve prej ditës së paraqitjes të ndonjë arsyeje në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Kufizimet në përdorimin e letërnjoftimit për kalimin e kufirit shtetëror**

#### **Neni 19a**

Përrjashtimisht nga neni 1, paragrafi 3 i këtij ligji, letërnjoftimi nuk mund të përdoret si dokument udhëtimi dhe se me përdorimin e tij zëvendësohet përdorimi i dokumenteve të udhëtimit dhe të kalohet kufiri shtetëror në qoftë se kushtet për konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit janë përbushur - të përcaktuara me ligjin i cili rregullon dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Serbisë jashtë vendit.

Nëse janë përbushur kushtet në paragrafin 1 të këtij neni, organi kompetent do të sjellë një vendim që ndalon përdorimin e letërnjoftimit si dokument udhëtimi, i cili është i vlefshëm për gjashtë muaj dhe të cilin ia dorëzon poseduesit dhe organit në të cilin ka paraqitur kërkesën.

Organi sipas kërkesës së të cilit është marrë vendimi për ndalimin e përdorimit të letërnjoftimit mund të rinovojë kërkesën për ndalimin e përdorimit të letërnjoftimit për kalimin e kufirit shtetëror përderisa ekzistojnë arsyet nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Ndërprerja e vlefshmërisë së letërnjoftimit**

### **Neni 20**

Letërnjoftimi pushon të vlejë:

- 1) pas skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar;
- 2) vdekjes së poseduesit;
- 3) nëse poseduesi ndalon së plotësuari kërkesat nga neni 2 i këtij ligji.

Në rastin nga pika 1 paragrafi 1 i këtij neni, personi i cili sipas dispozitave të këtij ligji është i obliguar të ketëletërnjoftim, është i detyruar që të bëjë kërkesën për letërnjoftim të ri brenda 15 ditëve pas skadimit të afatit në të cilin iu është lëshuar letërnjoftimi i mëparshëm.

Personi i cili është në posedim të letërnjoftimit të një personi të vdekur ose një personi të përmendur në pikën 3 të paragrafit 1 të këtij neni, është i detyruar t'ia kthejë letërnjoftimin organit kompetent për asgjësim brenda 15 ditëve nga data e skadimit të letërnjoftimit.

## **Legjitimimi. Ndalimi i keqpërdorimit**

### **Neni 21**

Personi i cili në bazë të dispozitave të këtij ligji është i obliguar të ketëletërnjoftim është i detyruar ta mbajë atë dhe ta tregojë me kërkesë të zyrtarit të autorizuar për ta legjitimuar.

Është e ndaluar që letërnjoftimi ti jepet një personi tjetër për tu shërbyer sikurse me qenë i tij, gjegjësisht për tu shërbyer me letërnjoftimin e huaj sikur të jetë i tij apo në mënyrë tjetër të keqpërdoret.

## **Humbja dhe gjetja e letërnjoftimit.**

### **Neni 22**



Personi i cili mbetet pa letërnjoftim apo gjen letërnjoftimin e huaj është i obliguar që menjëherë ta deklarojë humbjen apo gjetjen e letërnjoftimit te organi kompetent.

Nëse letërnjoftimi është humbur apo gjetur jashtë vendit, personi sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i obliguar që humbjen apo gjetjen e tij t'ia paraqesë përfaqësisë diplomatike apo konsullore të Republikës së Serbisë e cila do të informojë rreth kësaj organin kompetent.

## **Letërnjoftimi i pavlefshëm**

### **Neni 23**

Letërnjoftimin e humbur organi kompetent me anë të vendimit e deklaron të pavlefshëm. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohen ankesa.

Letërnjoftimi i deklaruar si i pavlefshëm publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë" me shpenzime të personit letërnjoftimi i të cilit shpallet i pavlefshëm.

Organi kompetent do ta lëshoj letërnjoftimin pas marrjes së vendimit mbi shpalljen e letërnjoftimit të pavlefshëm dhe pas dorëzimit të vendimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

## **Shpenzimet e lëshimit të letërnjoftimit. Lirimi nga pagesa e tatimit**

### **Neni 24**

Për lëshimin e letërnjoftimit paguhet kompensim, i cili përfshin çmimin e formularit të letërnjoftimit dhe shpenzimet e përpunimit teknik.

Çmimi i formularit të letërnjoftimit dhe shpenzimet e përpunimit teknik i përcakton ministri.

Në procesin e lëshimit të letërnjoftimit nuk paguhet taksa.

## **VII EVIDENCA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE**

### **Evidenca e letërnjoftimeve. Kompetenca për mbajtjen e evidencës.**

#### **Neni 25**

Për letërnjoftimet e lëshuara, për kërkesat e paraqitura për lëshim të letërnjoftimit, për letërnjoftimet të cilat janë asgjësuar, si dhe për letërnjoftimet të cilat janë shpallur të pavlefshme mbahet evidencë (në tekstin e mëtejme: evidenca për letërnjoftimet).

Evidencën për letërnjoftimet e mban organi kompetent.

Mënyrën e mbajtjes së evidencës së letërnjoftimeve dhe formularin për mbajtjen e evidencës e përcakton ministri.

Në mbajtjen e evidencës së letërnjoftimeve, në mjetet për përpunimin automatik të të dhënave, zbatohen masat mbrojtëse kundër qasjes së paautorizuar dhe ruajtjen e të dhënave në formën në të cilën është formuar, gjegjesisht pranuar.

### **Përmbajtja e evidencës**

#### **Neni 26**

Evidenca mbi letërnjoftimet përmban të dhënat mbi: parashtruesin e kërkesës sipas nenit 13 të këtij ligji dhe fotografive të të dhënave të tij biometrike; numrin serial dhe atë të regjistrimit të letërnjoftimit; afatin e vlefshmërisë dhe datën e lëshimit të letërnjoftimit; arsyet për asgjësimin e letërnjoftimit dhe letërnjoftimet e pavlefshme.

Evidenca përmban edhe të dhëna në bazë të së cilave mund të identifikohet zyrtari në organin kompetent i cili ka vendosur për kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit.

### **Saktësia e të dhënave. Mbrojtja e të dhënave**

#### **Neni 27**

Evidenca për letërnjoftimet duhet të jetë e azhuruar, e saktë dhe me masa të sigurta të mbrojtura nga qasjadhe përdorimi i paautorizuar.

### **Përdorimi i të dhënave**

## **Neni 28**

Organi kompetent të dhënat nga evidenca mund t'ia japë organeve shtetërore, organeve tjera dhe organizatave, si dhe personave juridik dhe fizik, sipas kushteve të mëposhtme:

- 1) që subjekti që kërkon të dhënat të jetë me ligj ose rregullore tjera i autorizuar të kërkoj dhe të pranoj të dhëna të tilla;
- 2) që ato të dhëna të cilat kërkon subjekti të jenë të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tij;
- 3) që subjekti i cili kërkon të dhënat të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale.

## **VIII DISPOZITAT NDËSHKUESE**

### **Kundërvajtjet**

## **Neni 29**

Me gjobë deri në 50.000 dinarë, ose me burgim deri 30 ditë do të ndëshkohet për kundërvajtje personi i cili:

- 1) në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar nuk ka letërnjoftim (neni 3);
- 2) në afatin e caktuar kohore nuk paraqet kërkesën e lëshimit të letërnjoftimit (neni 11 dhe 20, paragrafi 2);
- 3) në kërkesën për letërnjoftim deklaron të dhëna të pavërteta (neni 12);
- 4) përdor letërnjoftimin të cilin nuk guxon ta përdorë (neni 19);
- 5) përdorë letërnjoftimin në kundërshtim me ndalimin e përdorimit të letërnjoftimit si dokument udhëtimi (neni 19a paragrafi 2);

6) refuzon ti paraqesë letërnjoftimin personit të autorizuar zyrtarpër talegjitimuar (neni 21 paragrafi 1);

7) i jep letërnjoftimin një personi tjetër për tu shërbyer sikur me të vetën, ose përdor letërnjoftimin e dikujt tjetër sikur të vetin apo në ndonjë mënyrë tjetër e keqpërdor (neni 21, paragrafi 2).

### **Neni 30**

Me gjobë prej 5.000 dinarë, ndëshkohet për kundërvajtje personi i cili:

1) në afat të caktuar nuk ia kthen letërnjoftimin organit kompetent me qëllim të asgjësimit (neni 20. paragrafi 3);

2) nuk mbanë letërnjoftimin, ndërsa është e obligueshme ta mbajë (neni 21. paragrafi 1);

3) menjëherë nuk e raporton humbjen apo gjetjen e letërnjoftimit (neni 22).

4) *(është fshirë)*

## **IX DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Vlefshmëria e letërnjoftimit të lëshuar sipas dispozitave të mëparshme.**

### **Neni 31**

Letërnjoftimi i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen deri në afatin e përcaktuar nëletërnjoftim, maksimalisht pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Zbatimi i Ligjit për qytetarët e Serbisë dhe Malit të Zi me vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë**

### **Neni 32**

Për shtetasit e Serbisë dhe Malit të Zi me vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë që nuk kanë shtetësinë e Republikës së Serbisë, zbatohen dispozitat e këtij ligji, maksimalisht pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Procedurat me kërkesat e pa zgjidhura**

### **Neni 33**

Procedura për zgjidhjen e kërkesës për lëshimin e letërnjoftimit e filluar para aplikimit të këtij ligji do të përfundoj sipas dispozitave të këtij ligji.

## **Afati për miratimin e akteve nënligjore. Zbatimi i rregullave të mëparshme**

### **Neni 34**

Aktet nënligjore të përcaktuara në nenin 6, paragrafin 2, nenin 7, paragrafin 1, nenin 8, paragrafin 2, nenin 10, paragrafin 7, nenin 14, paragrafin 2, neni 15, neni 17, paragrafin 2, nenin 18, paragrafin 2, neni 24, paragrafin 2 dhe nenin 25 paragrafin 3 të këtij ligji, ministri do timiratoj brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri tej fillimi i zbatimit të akteve nënligjore nga paragrafi 1. të këtij neni, aplikohen dispozitat e miratuara ngadita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

## **Shfuqizimii ligjit**

### **Neni 35**

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji pushon të vlejë Ligji mbi të dhënat bazë për letërnjoftimin ( "Gazeta Zyrtare SFRJ, Nr 6/73) dhe Ligjit për Letërnjoftimin ("Gazeta Zyrtare e SRS" nr. 15/74, 54/77, 57/80, 45/85 dhe 40/88 dhe "Gazeta Zyrtare e RS", nr 53/93 - ligji i tjetër, 67/93 - ligji i radhës, 48/94 - ligji i radhës dhe 101/05 -ligji i radhës).

## **Hyrja në fuqi e ligjit dhe fillimi i zbatimit**

### **Neni 36**

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë", ndërsa fillon të zbatohet pas gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi.

## **Nenet e pavarura të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për Letërnjoftimin**

("Gazeta zyrtare RS", nr. 36/2011)

### **Neni 11[s1]**

Letërnjoftimi i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen deri në afatin e përcaktuar nëletërnjoftim, ndërsa më së vonë deri 31 dhjetor 2016 –deri në afatin të cilin vlejné letërnjoftimet të lëshuara pas fillimit të zbatimit të Ligjit për Letërnjoftimin ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 62/06), me periudhë të vlefshmërisë "27 korrik 2011"

### **Neni 12[s1]**

Ky ligj hyn ne fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

